

BANKA E SHQIPËRISË

B U L E T I N I  
Z Y R T A R

---

vëllimi 27 numër 7 dhjetor 2025

Data e botimit: 31.12.2025



P Ë R M B A J T J A

1. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr.51, datë 1.10.2025 "Për mbajtjen e pandryshuar të normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes dhe të normave të interesit të depozitës njëditore dhe të kredisë njëditore në Bankën e Shqipërisë" 5
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr.52, datë 1.10.2025 "Për miratimin e disa ndryshimeve në rregulloren "Për marrëdhëniet e punës të personelit të Bankës së Shqipërisë", miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 21, datë 16.5.2007, i ndryshuar" 7
3. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr.53, datë 1.10.2025 "Për miratimin e disa ndryshimeve në rregulloren "Për strukturën e pagave bazuar në klasifikimin e vendeve përkatëse të punës në Bankën e Shqipërisë", miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 108, datë 24.12.2003, i ndryshuar"" 9
4. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr.55, datë 1.10.2025 "Për zgjedhjen e "Reinventing Bretton Woods Committee (RBWC)", si bashkëpunëtor i jashtëm i Bankës së Shqipërisë dhe delegimin e kompetencës për nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit" 11
5. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr.57, datë 1.10.2025 "Për dhënien e miratimit paraprak për zotërimin e pjesëmarrjes influencuese (të tërthortë) në kapitalin aksioner të "Bankës Amerikane të Investimeve" sh.a." 13
6. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr.58, datë 5.11.2025 "Për miratimin e raportit tremujor të politikës monetare" 15
7. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr.59, datë 5.11.2025 "Për mbajtjen e pandryshuar të normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes dhe të normave të interesit të depozitës njëditore dhe të kredisë njëditore në Bankën e Shqipërisë" 16
8. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr.61, datë 5.11.2025 "Për dhënien e miratimit paraprak për bashkimin me përtithje të Bankës Amerikane të Investimeve sh.a. me subjektin financiar jobankë NOA sh.a." 18
9. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr.62, datë 5.11.2025 "Për ekspozimin e disa vlerave numizmatike, pjesë e fondit numizmatik të Bankës së Shqipërisë, në ekspozitën e organizuar me rastin e "100-vjetorit të Bankës së Shqipërisë"" 20
10. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr.66, datë 3.12.2025 "Për dhënien e miratimit paraprak për licencimin e bankës "Jet Bank" në Republikën e Shqipërisë" 22
11. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr.68, datë 17.12.2025 "Për mbajtjen e pandryshuar të normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes dhe të normave

të interesit të depozitës njëditore dhe të kredisë njëditore në Bankën e Shqipërisë"	24
12. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr.69, datë 17.12.2025 "Për disa ndryshime në vendimin nr. 3, datë 15.1.2025 të Këshillit Mbikëqyrës "Për miratimin e programit të biznesit mikro, të vogël dhe të mesëm në Shqipëri dhe dokumentacionit shoqërues"	26
13. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr.71, datë 17.12.2025 "Për miratimin e emërimit të drejtorit të Departamentit të Sigurimit dhe Mbrojtjes të Bankës së Shqipërisë"	28
14. Licencë nr.57 datë 17.12.2025 "Për të vepruar si institucion i parasë elektronike në Republikën e Shqipërisë"	29
1. Treguesi i lëndës për buletin zyrtar, vëllimi 27, numër 1, mars 2025	31
2. Treguesi i lëndës për buletin zyrtar, vëllimi 27, numër 2, maj 2025	31
3. Treguesi i lëndës për buletin zyrtar, vëllimi 27, numër 3, gusht 2025	32
4. Treguesi i lëndës për buletin zyrtar, vëllimi 27, numër 4, shtator 2025	32
5. Treguesi i lëndës për buletin zyrtar, vëllimi 27, numër 5, shtator 2025	32
6. Treguesi i lëndës për buletin zyrtar, vëllimi 27, numër 6, shtator 2025	33



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BANKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI MBIKËQYRËS**

VENDIM  
Nr. 51, datë 1.10.2025

**PËR**  
**MBAJTJEN E PANDRYSHUAR TË NORMËS SË INTERESIT TË**  
**MARRËVESHJEVE TË RIBLERJES DHE TË ANASJELLA TË RIBLERJES DHE**  
**TË NORMAVE TË INTERESIT TË DEPOZITËS NJËDITORE DHE TË KREDISË**  
**NJËDITORE NË BANKËN E SHQIPËRISË**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronjat "a" dhe "c" të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", të ndryshuar; me propozimin e Departamentit të Politikës Monetare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të mbajë të pandryshuar, në nivelin 2.50 për qind, normën e interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes (REPO dhe REPO të anasjella).
2. Të mbajë të pandryshuar, në nivelin 1.50 për qind, normën e interesit që Banka e Shqipërisë i paguan një banke tregtare për depozitën njëditore.
3. Të mbajë të pandryshuar, në nivelin 3.50 për qind, normën e interesit që një bankë tregtare i paguan Bankës së Shqipërisë për kredinë njëditore.
4. Ngarkohet Departamenti i Operacioneve Monetare të njoftojë menjëherë bankat tregtare për këtë vendim.
5. Ngarkohen Departamenti i Operacioneve Monetare dhe të gjitha strukturat e tjera në Bankën e Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

6. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në faqen zyrtare të internetit dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SEKRETARI**

**KRYETARI**

**ELVIS ÇIBUKU**

**GENT SEJKO**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BANKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI MBIKËQYRËS**

VENDIM  
Nr. 52, datë 1.10.2025

**PËR**  
**MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË RREGULLOREN**  
**“PËR MARRËDHËNIET E PUNËS TË PERSONELIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË”,**  
**MIRATUAR ME VENDIMIN E KËSHILLIT MBIKËQYRËS NR. 21, DATË**  
**16.5.2007, I NDRYSHUAR**

Në bazë të nenit 43, shkronjat “f” dhe “h”, nenit 55, pika 2 të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; me propozim të Departamentit të Burimeve Njerëzore, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Në vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.21, datë 16.5.2007, për miratimin e rregullores “Për marrëdhëniet e punës të personelit të Bankës së Shqipërisë”, i ndryshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:
  - a) në nenin 9 “Shpallja e konkurimit”, përmbajtja e pikës 1, ndryshon si më poshtë:  
*“Procedurat e zhvillimit të konkursit, si dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve bëhen kurdoherë publike, duke u shpallur për 3 ditë radhazi nga Departamenti i Burimeve Njerëzore në faqen zyrtare të internetit të Bankës, dhe/ose në zyrat e punësimit, jo më vonë se 20 ditë para datës së caktuar për zhvillimin e konkursit.”;*
  - b) në nenin 16 “Pranimi në punë pa konkurrim”, përmbajtja e pikës 1, shkronja “d”, ndryshon si më poshtë:  
*“Emërimi pa konkurrim zbatohet edhe për kategori të tjera pozicionesh pune, si punonjësit e Kabinetit të Guvernatorit, zyrave të Administratorëve, Zyrës së Inspektorit të Përgjithshëm, si dhe për punësime të kategorive të personelit: “specialistë me arsim të mesëm”, si dhe “punonjës me arsimin bazë të nivelit fillor 9-vjeçar, ose ekuivalentin e tij.”;*

- c) në "Aneksin I", përmbajtja e pikës 13, ndryshon si më poshtë:  
*"Dëftesa e shkollës së mesme, ose dëftesa e arsimit bazë të nivelit fillor 9-vjeçar, ose ekuivalentja e tij, për ato raste të pozicioneve të punës që përcaktojnë arsimim jouniversitar/të lartë."*
2. Ngarkohet Departamenti i Burimeve Njerezore i Bankës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar dhe në faqen e internetit të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SEKRETARI**

**ELVIS ÇIBUKU**

**KRYETARI**

**GENT SEJKO**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BANKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

**VENDIM**  
Nr. 53, datë 1.10.2025

**PËR  
MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË RREGULLOREN  
"PËR STRUKTURËN E PAGAVE BAZUAR NË KLASIFIKIMIN E VENDEVE  
PËRKATËSE TË PUNËS NË BANKËN E SHQIPËRISË", MIRATUAR ME  
VENDIMIN E KËSHILLIT MBIKËQYRËS NR. 108, DATË 24.12.2003, I  
NDRYSHUAR**

Në bazë të nenit 43, shkronjat "f" dhe nenit 45, pika 2 të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; me propozim të Departamentit të Burimeve Njerëzore, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

**VENDOSI:**

1. Në vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.108, datë 24.12.2003, për miratimin e rregullores "Për strukturën e pagave bazuar në klasifikimin e vendeve përkatëse të punës në Bankën e Shqipërisë", e ndryshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:
  - a) në nenin 2, pika 5, shkronja "b", përmbajtja e paragrafëve "Grupi "B" dhe "Grupi "C"", ndryshon si më poshtë:

*"Grupi "B" përfshin vendet e punës: Punonjës ndihmës në Departamentin e Emisionit, specialistë mirëmbajtës makinerish/vëzhgues në kamera, shoferë automjeti në administratë, shoferë dhe teknikë mirëmbajtës në degë.*

*Grupi "C" përfshin vendet e punës: Punonjës me arsimin bazë të nivelit fillor 9-vjeçar, ose ekuivalentin e tij, që përfshijnë punonjës ndihmës ngarkim/shkarkimi, ngarkim/transport, lavazhierë dhe pastrues, bojaxhinj, dhe punëtorë pastrimi."*
2. Ngarkohet Departamenti i Burimeve Njerëzore i Bankës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar dhe në faqen e internetit të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SEKRETARI**

**KRYETARI**

**ELVIS ÇIBUKU**

**GENT SEJKO**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BANKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI MBIKËQYRËS**

**VENDIM**  
Nr. 55, datë 1.10.2025

**PËR**

**ZGJEDHJEN E "REINVENTING BRETTON WOODS COMMITTEE (RBWC)", SI BASHKËPUNËTOR I JASHTËM I BANKËS SË SHQIPËRISË DHE DELEGIMIN E KOMPETENCËS PËR NËNSHKRIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT**

Në mbështetje të nenit 43, shkronja "g", dhe nenit 53, pika 4, paragrafi i fundit i ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; të nenit 8, pika 2, dhe nenit 11 të rregullores "Mbi marrëdhëniet e Bankës së Shqipërisë me bashkëpunëtorë të jashtëm", miratuar me vendimin nr. 54, datë 28.7.2010, të Këshillit Mbikëqyrës; të neneve 28 dhe 29 të ligjit 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", me propozim të Departamentit të Kërkimeve dhe Guvernatorit, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë zgjedhjen e "Reinventing Bretton Woods Committee (RBWC)" (i referuar më poshtë si RBWC), si bashkëpunëtor të jashtëm të Bankës së Shqipërisë.
2. Objekti i bashkëpunimit do të jetë përgatitja e punimeve dhe librit të konferencës që do të organizohet me rastin e 100-vjetorit të themelimit të Bankës së Shqipërisë, më 10-11 nëntor 2025, si dhe të aktiviteteve të tjera akademike.
3. Në kuadër të organizimit të konferencës së nivelit të lartë të parashikuar me rastin e 100-vjetorit të themelimit të Bankës së Shqipërisë, bashkëpunimi do të fokusohet më konkretisht në trajtimin e tematikave të mëposhtme:
  - a. pasiguria dhe transformimet gjeopolitike: roli i bankave qendrore në një botë në ndryshim;
  - b. rritja e fragmentimit ekonomik dhe financiar: ndikimi në stabilitetin

- monetar dhe tregjet ndërkombëtare;
- c. avancimet teknologjike dhe transformimi digjital i parasë: sfidat dhe mundësitë për bankat qendrore;
  - d. perspektiva për vendet e Ballkanit Perëndimor: qëndrueshmëria makroekonomike dhe integrimi evropian.
4. Realizimi i aktiviteteve të tjera brenda buxhetit në dispozicion, të tilla si:
    - a. përgatitja dhe botimi i një publikimi të përbashkët, si rezultat i këtij bashkëpunimi;
    - b. shkëmbimi i ideve dhe diskutimeve me stafin e Bankës së Shqipërisë mbi kërkimin dhe politikat që lidhen me zhvillimet në Evropën Qendrore, Lindore dhe Juglindore;
    - c. organizimi i tryezave të brendshme mbi praktikatat më të mira ndërkombëtare në fushën e kërkimit, hartimit dhe zbatimit të politikave.
  5. Afati për realizimin e objektit të bashkëpunimit, përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi, do të jetë për një periudhë 6-mujore nga data e hyrjes në fuqi të marrëveshjes të lidhur mes palëve.
  6. Fondi i nevojshëm për realizimin e objektit të bashkëpunimit, përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi, është € 10,000 (dhjetë mijë euro).
  7. Të autorizojë zj. Luljeta Minxhozi, Zëvendësguvernatore e Parë, për nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit midis Bankës së Shqipërisë dhe bashkëpunëtorit të jashtëm të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi.
  8. Ngarkohen Departamenti i Kërkimeve dhe Departamenti i Sistemeve të Pagesave dhe Kontabilitetit e Financës për zbatimin e këtij vendimi.
  9. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SEKRETARI**

**ELVIS ÇIBUKU**

**KRYETARI**

**GENT SEJKO**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BANKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI MBIKËQYRËS**

**VENDIM**  
Nr. 57, datë 1.10.2025

**PËR**  
**DHËNIEN E MIRATIMIT PARAPRAK PËR ZOTËRIMIN E PJESËMARRJES**  
**INFLUENCUESE (TË TËRTHORTË) NË KAPITALIN AKSIONER TË "BANKËS**  
**AMERIKANE TË INVESTIMEVE" SH.A.**

Në bazë dhe për zbatim të shkronjës "e" të nenit 43 të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; të shkronjës "gj" të pikës 1 të nenit 24, dhe nenit 25 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; si dhe të rregullores "Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe të degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë", miratuar me vendimin nr. 14, datë 11.3.2009, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, e ndryshuar; me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

**VENDOSI:**

1. Të japë miratimin paraparak për zotërimin e pjesëmarrjes influencuese (të tërthortë) në masën 23.68% të shoqërisë "MOSCOPOLE II" L.L.C, SHBA, në kapitalin aksioner të Bankës Amerikane të Investimeve sh.a.
2. Ngarkohet Banka Amerikane e Investimeve të njoftojë Bankën e Shqipërisë për përfundimin e transaksionit të përmendur në pikën 1 të këtij vendimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
4. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**SEKRETARI**

**KRYETARI**

**ELVIS ÇIBUKU**

**GENT SEJKO**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BANKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

**VENDIM**  
Nr. 58, datë 5.11.2025

**PËR  
MIRATIMIN E RAPORTIT TREMUJOR TË POLITIKËS MONETARE**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronja "ç" dhe të nenit 69, pika 5 të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë" i ndryshuar; me propozimin e Departamentit të Politikës Monetare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë "Raportin tremujor të politikës monetare", sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve për publikimin dhe për dërgimin e këtij raporti në Kuvendin e Shqipërisë, në Këshillin e Ministrave dhe në institucionet e tjera përkatëse.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SEKRETARI**

**ELVIS ÇIBUKU**

**KRYETARI**

**GENT SEJKO**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BANKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI MBIKËQYRËS**

VENDIM  
Nr. 59, datë 5.11.2025

**PËR**  
**MBAJTJEN E PANDRYSHUAR TË NORMËS SË INTERESIT TË MAR-**  
**RËVESHJEVE TË RIBLERJES DHE TË ANASJELLA TË RIBLERJES DHE TË NOR-**  
**MAVE TË INTERESIT TË DEPOZITËS NJËDITORE DHE TË KREDISË NJËDITORE**  
**NË BANKËN E SHQIPËRISË**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronjat "a" dhe "c" të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", të ndryshuar; me propozimin e Departamentit të Politikës Monetare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të mbajë të pandryshuar, në nivelin 2.50 për qind, normën e interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes (REPO dhe REPO të anasjella).
2. Të mbajë të pandryshuar, në nivelin 1.50 për qind, normën e interesit që Banka e Shqipërisë i paguan një banke tregtare për depozitën njëditore.
3. Të mbajë të pandryshuar, në nivelin 3.50 për qind, normën e interesit që një bankë tregtare i paguan Bankës së Shqipërisë për kredinë njëditore.
4. Ngarkohet Departamenti i Operacioneve Monetare të njoftojë menjëherë bankat tregtare për këtë vendim.
5. Ngarkohen Departamenti i Operacioneve Monetare dhe të gjitha strukturat e tjera në Bankën e Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

6. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në faqen zyrtare të internetit dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SEKRETARI**

**ELVIS ÇIBUKU**

**KRYETARI**

**GENT SEJKO**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BANKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI MBIKËQYRËS**

**VENDIM**  
Nr. 61, datë 5.11.2025

**PËR**  
**DHËNIEN E MIRATIMIT PARAPRAK PËR**  
**BASHKIMIN ME PËRTHITHJE TË BANKËS AMERIKANE TË INVESTIMEVE**  
**SH.A. ME SUBJEKTIN FINANCIAR JOBANKË NOA SH.A.**

Në bazë dhe për zbatim të shkronjës "e" të nenit 43 të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; të shkronjës "k" të pikës 1 të nenit 24 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; të rregullores "Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe të degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë", miratuar me vendimin nr. 14, datë 11.3.2009, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, e ndryshuar; dhe të pikës 7 të Shtojcës nr. 1 të rregullores "Për përcaktimin e nivelit të vendimmarrjes në mbikëqyrjen e veprimtarive bankare dhe financiare", miratuar me vendimin nr. 36, datë 26.5.2010, të Këshillit Mbikëqyrës, e ndryshuar, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

**VENDOSI:**

1. Të japë miratimin paraprak për bashkimin me përthithje të Bankës Amerikane të Investimeve sh.a. (shoqëria përthithëse) me subjektin financiar jobankë NOA sh.a. (shoqëria e përthithur).
2. Banka Amerikane e Investimeve sh.a. (shoqëria përthithëse) duhet të njoftojë Bankën e Shqipërisë për përfundimin e procesit të bashkimit me përthithje.
3. Banka Amerikane e Investimeve sh.a. (shoqëria përthithëse) do të ushtrojë vetëm veprimtaritë bankare dhe financiare për të cilat është licencuar sipas aneksit të licencës së saj.

4. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
5. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SEKRETARI**

**ELVIS ÇIBUKU**

**KRYETARI**

**GENT SEJKO**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BANKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI MBIKËQYRËS**

**VENDIM**  
Nr. 62, datë 5.11.2025

**PËR**  
**EKSPOZIMIN E DISA VLERAVE NUMIZMATIKE, PJESË E FONDIT**  
**NUMIZMATIK TË BANKËS SË SHQIPËRISË, NË EKSPOZITËN E**  
**ORGANIZUAR ME RASTIN E "100-VJETORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË"**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronja "g", të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; të nenit 9, pika 2, shkronja "d", dhe nenit 14, shkronja "b", të rregullores "Për funksionimin e Departamentit të Kërkimeve", miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 42, datë 30.3.2016; të nenit 5, pika 1, shkronja b, të nenit 6, pika "a", të rregullores "Për organizimin e ekspozitave të përkohshme të vlerave numizmatike dhe objekteve muzeore të Bankës së Shqipërisë, brenda dhe jashtë Bankës së Shqipërisë", miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 50, datë 3.9.2025; me propozim të Departamentit të Kërkimeve, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

**VENDOSI:**

1. Në kuadër të festimeve në përkujtim të 100-vjetorit të themelimit të Bankës së Shqipërisë, të miratojë ekspozimin e monedhave me metal ar dhe argjend, pjesë e fondit numizmatik të Muzeut të Bankës së Shqipërisë, në ekspozitën e Bankës së Shqipërisë që do të organizohet në selinë qendrore nr. 2 të Bankës, në datat 28 nëntor 2025 – 28 maj 2026, sipas aneksit nr. 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Ngarkohen Departamenti i Emisionit, Departamenti i Kërkimeve, Departamenti i Sistemit të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës dhe komisioni i Administrimit të Vlerave të Ekspozitës që do të ngrihet për këtë qëllim, me ndjekjen e procedurave përkatëse të kalimit të vlerave nga/për në Arkën Stok te Fondi i Muzeut në mjediset e Muzeut dhe të ekspozitës gjatë periudhës së ekspozimit të tyre.

3. Ngarkohet Departamenti i Sigurimit dhe Mbrojtjes me ndjekjen e procedurave për transportin e vlerave numizmatike, miratuar sipas pikës nr.1 të këtij vendimi, nga Banka e Shqipërisë në ekspozita dhe anasjelltas.
4. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi pa Aneksin 1 bashkëlidhur në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SEKRETARI**

**ELVIS ÇIBUKU**

**KRYETARI**

**GENT SEJKO**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BANKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI MBIKËQYRËS**

**VENDIM**  
Nr. 66, datë 3.12.2025

**PËR**  
**DHËNIEN E MIRATIMIT PARAPRAK**  
**PËR LICENCIMIN E BANKËS "JET BANK" NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Në bazë dhe për zbatim të shkronjës "e" të nenit 43 të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; të pikave 1 dhe 2 të nenit 19 të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006, "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; të rregullores "Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe të degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë", miratuar me vendimin nr. 14, datë 11.3.2009, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, e ndryshuar; dhe të pikës 1 të Shtojcës nr. 1 të rregullores "Për përcaktimin e nivelit të vendimmarrjes në mbikëqyrjen e veprimtarive bankare dhe financiare", miratuar me vendimin nr. 36, datë 26.5.2010, të Këshillit Mbikëqyrës, e ndryshuar; si dhe me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të japë miratimin paraprak për licencimin e bankës "Jet Bank" në Republikën e Shqipërisë.
2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
3. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SEKRETARI**

**ELVIS ÇIBUKU**

**KRYETARI**

**GENT SEJKO**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BANKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI MBIKËQYRËS**

VENDIM  
Nr. 68, datë 17.12.2025

**PËR**  
**MBAJTJEN E PANDRYSHUAR TË NORMËS SË INTERESIT TË**  
**MARRËVESHJEVE TË RIBLERJES DHE TË ANASJELLA TË RIBLERJES DHE**  
**TË NORMAVE TË INTERESIT TË DEPOZITËS NJËDITORE DHE TË KREDISË**  
**NJËDITORE NË BANKËN E SHQIPËRISË**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronjat "a" dhe "c" të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", të ndryshuar; me propozimin e Departamentit të Politikës Monetare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të mbajë të pandryshuar, në nivelin 2.50 për qind, normën e interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes (REPO dhe REPO të anasjella).
2. Të mbajë të pandryshuar, në nivelin 1.50 për qind, normën e interesit që Banka e Shqipërisë i paguan një banke tregtare për depozitën njëditore.
3. Të mbajë të pandryshuar, në nivelin 3.50 për qind, normën e interesit që një bankë tregtare i paguan Bankës së Shqipërisë për kredinë njëditore.
4. Ngarkohet Departamenti i Operacioneve Monetare të njoftojë menjëherë bankat tregtare për këtë vendim.
5. Ngarkohen Departamenti i Operacioneve Monetare dhe të gjitha strukturat e tjera në Bankën e Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

6. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në faqen zyrtare të internetit dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SEKRETARI**

**ELVIS ÇIBUKU**

**KRYETARI**

**GENT SEJKO**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BANKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

**VENDIM**  
Nr. 69, datë 17.12.2025

**PËR  
DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 3, DATË 15.1.2025 TË KËSHILLIT  
MBIKËQYRËS "PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT TË BIZNESIT MIKRO,  
TË VOGËL DHE TË MESËM NË SHQIPËRI DHE DOKUMENTACIONIT  
SHOQËRUES**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 1, pika 4, shkronja "a", nenit 16, pika 1, shkronja "i", nenit 43, shkronjat "a" dhe "c" i ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; të nenit 3, pika 7 të rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Komitetit të Zbatimit dhe Këshillimit të Politikës Monetare", miratuar me vendimin nr. 81, datë 16.12.2020 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, i ndryshuar, me propozimin e Departamentit të Politikës Monetare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Në vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 3, datë 15.1.2025 të Këshillit Mbikëqyrës "Për miratimin e Programit të Biznesit Mikro, të Vogël dhe të Mesëm në Shqipëri dhe dokumentacionit shoqëruës", bëhen ndryshimet e mëposhtme:
  - a) Në pikën 1, Aneksi 1, në pikën B.1., paragrafi i parë ndryshon si më poshtë:

*"Afati fillestar i disbursimit të kredive. Afati maksimal kohor për disbursimin e kredive që do të jenë pjesë e PFBVM, dhe për aksesin fillestar të tyre në instrumentin e refinancimit të Bankës së Shqipërisë, është data 31 dhjetor 2026".*

- b) Në pikën 2, Aneksi 2, bëhen ndryshimet e mëposhtme:
- i. neni 3, pika 2, ndryshohet me përmbajtje si vijon: "Kohëzgjatja e PFBVM do të jetë deri në datën 31.12.2031".
  - ii. neni 4, pika 2, ndryshohet me përmbajtje si vijon: "Bankat duhet të disbursojnë kreditë në favor të BVM-ve, brenda datës 20.12.2026".
2. Ngarkohen Departamenti i Politikës Monetare, Departamenti i Operacioneve Monetare, Departamenti i Statistikave Financiare dhe Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SEKRETARI**

**ELVIS ÇIBUKU**

**KRYETARI**

**GENT SEJKO**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BANKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

**VENDIM**  
Nr. 71, datë 17.12.2025

**PËR  
MIRATIMIN E EMËRIMIT TË DREJTORIT TË DEPARTAMENTIT TË  
SIGURIMIT DHE MBROJTJES TË BANKËS SË SHQIPËRISË**

Në bazë të nenit 43, shkronja "h" të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë" i ndryshuar; nenit 18 pika "b" shkronja "i" të rregullores "Për marrëdhëniet e punës të personelit të Bankës së Shqipërisë", miratuar me vendimin nr. 21, datë 16.5.2007 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, i ndryshuar; të vendimit të Këshillit Mbikëqyrës nr. 79, datë 31.10.2005 "Për përcaktimin e strukturës organizative dhe numrin e punonjësve në organikë të Bankës së Shqipërisë" i ndryshuar; si dhe propozimit të Departamentit të Burimeve Njerëzore, bazuar në urdhrin e Guvernatorit për emërimin e z. Etrid Teliti, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë emërimin e z. Etrid Teliti në pozicionin e Drejtorit të Departamentit të Sigurimit dhe Mbrojtjes të Bankës së Shqipërisë.
2. Ngarkohet Departamenti i Burimeve Njerëzore me zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SEKRETARI**

**ELVIS ÇIBUKU**

**KRYETARI**

**GENT SEJKO**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BANKA E SHQIPËRISË**

LICENCË  
Nr. 57 datë 17.12.2025

**PËR TË VEPRUAR SI INSTITUCION I PARASË ELEKTRONIKE  
NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Në mbështetje të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; të ligjit nr. 55/2020, datë 30.4.2020 "Për shërbimet e pagesave"; si dhe të rregullores "Për licencimin e institucioneve të pagesave dhe institucioneve të parasë elektronike, si dhe për regjistrimin e ofruesve të shërbimeve të pagesave" miratuar me vendimin nr. 59, datë 24.11.2021 të Këshillit Mbikëqyrës; Banka e Shqipërisë i jep shoqërisë "Happy Pay" sh.a., licencën si institucion i parasë elektronike për të ushtruar veprimtaritë financiare të përshkruara në aneksin bashkëlidhur.

Licenca është e pakufizuar në kohë dhe nuk është e transferueshme ose e tjetërsueshme

**ZËVENDËSGUVERNATOR I DYTË**

**NATASHA AHMETAJ**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BANKA E SHQIPËRISË**

Tiranë, më 17.12.2025

**ANEKS**

**LICENCA NR. 57**

**VEPRIMTARITË E LEJUESHME PËR "HAPPY PAY" SH.A.**

Institucioni i parasë elektronike "Happy Pay" sh.a., në bazë të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, të ligjit nr. 55/2020, datë 30.4.2020 "Për shërbimet e pagesave" dhe të rregullores "Për licencimin e institucioneve të pagesave dhe institucioneve të parasë elektronike, si dhe për regjistrimin e ofruesve të shërbimeve të pagesave" miratuar me vendim nr. 59, datë 24.11.2021 të Këshillit Mbikëqyrës, është licencuar të kryejë veprimtarinë financiare:

1. Emetimi i parasë elektronike.
2. Ekzekutimi i transaksioneve të pagesave, ku fondet janë të mbuluara nga një linjë kredie për një përdorues të shërbimit të pagesave:
  - ekzekutimi i debitimeve direkte, duke përfshirë dhe debitimet direkte që bëhen vetëm një herë;
  - ekzekutimi i transaksioneve të pagesave përmes një karte pagese ose nga një pajisje e ngjashme;
  - ekzekutimi i transfertave të kreditit, duke përfshirë pagesat periodike.

**ZËVENDËSGUVERNATOR I DYTË**

**NATASHA AHMETAJ**

TREGUESI I LËNDËS PËR BULETININ ZYRTAR, VËLLIMI 27, NUMËR 1, MARS  
2025

1. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 3, datë 15.1.2025 për "Miratimin e Programit të Biznesit Mikro, të Vogël dhe të Mesëm në Shqipëri dhe dokumentacionit shoqërues"
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 9, datë 5.2.2025 "Për mbajtjen e pandryshuar të normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes dhe të normave të interesit të depozitës njëditore dhe të kredisë njëditore në Bankën e Shqipërisë"
3. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 10, datë 5.2.2025 "Për disa ndryshime në rregulloren "Për kredinë konsumatore dhe kredinë hipotekare""
4. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 11, datë 5.2.2025 "Për disa ndryshime në rregulloren "Mbi transparencën për produktet dhe shërbimet bankare e financiare""
5. Vendim i Zëvendësgovernatorit të Parë të Bankës së Shqipërisë, nr.prot. 1072, datë 4.3.2025 për "Miratimin e politikës së administrimit të mjeteve financiare të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme"
6. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr.14, datë 5.3.2025 "Për kryerjen e pagesës së rritjes së kuotës së anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Fondin Monetar Ndërkombëtar"

TREGUESI I LËNDËS PËR BULETININ ZYRTAR, VËLLIMI 27, NUMËR 2, MAJ  
2025

1. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr.16, datë 26.3.2025 "Për mbajtjen e pandryshuar të normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes dhe të normave të interesit të depozitës njëditore dhe të kredisë njëditore në Bankën e Shqipërisë"
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr.17, datë 26.3.2025 "Për miratimin e "Pasqyrave financiare të Bankës së Shqipërisë për vitin 2024""
3. Vendim i Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, nr.prot.1456, datë 28.3.2025 "Për caktimin e shtesave makroprudenciale të kapitalit"
4. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr.20, datë 2.4.2025 "Për disa ndryshime në rregulloren "Për organizimin dhe funksionimin e Departamentit të Mbikëqyrjes""
5. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr.22, datë 2.4.2025 "Për disa ndryshime në rregulloren "Për nxjerrjen e vlerave materiale jashtë përdorimit""
6. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr.24, datë 7.5.2025 "Për mbajtjen e pandryshuar të normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes dhe të normave të interesit të depozitës njëditore dhe të kredisë njëditore në Bankën e Shqipërisë"
7. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr.25, datë 7.5.2025 "Për vendosjen e kufijve të sipërm për treguesit "Raporti i kredisë ndaj vlerës" dhe "Raporti i shërbimit të borxhit ndaj të ardhurave" për kreditë që japin bankat për pasuri të paluajtshme rezidenciale"
8. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr.26, datë

- 7.5.2025 "Për disa ndryshime në rregulloren "Për shtypjen, rishtypjen, hedhjen dhe tërheqjen nga çarkullimi të kartëmonedhave dhe monedhave metalike shqiptare me kurs ligjor""
9. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr.27, datë 7.5.2025 "Për rishtypjen e kartëmonedhave shqiptare me kurs ligjor, me prerje 2000 Lekë"

TREGUESI I LËNDËS PËR BULETININ ZYRTAR, VËLLIMI 27, NUMËR 3,  
GUSHT 2025

1. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr.28, datë 4.6.2025 "Për miratimin e një ndryshimi në statutin e Bankës së Shqipërisë"
2. Vendim i Zëvendës guvernatorit të Dytë të Bankës së Shqipërisë, nr.prot.2776, datë 16.6.2025 "Për shfuqizimin e licences së subjektit "NOA" sh.a. si institucion pagese"
3. Vendim i Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, nr.prot.3015, datë 30.6.2025 "Për caktimin e shtesës kundërciklike të kapitalit"
4. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr.30, datë 2.7.2025 "Për uljen e normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes dhe të normave të interesit të depozitës njëditore dhe të kredisë njëditore në Bankën e Shqipërisë"
5. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr.31, datë 2.7.2025 "Për disa ndryshime në rregulloren "Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit""
6. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr.32, datë 2.7.2025 "Për disa ndryshime në rregulloren "Për administrimin e rrezikut nga ekspozimet e mëdha të bankave""
7. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr.33, datë 2.7.2025 "Për një ndryshim në rregulloren "Për mbikëqyrjen e konsoliduar""
8. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr.35, datë 2.7.2025 "Për rishtypjen e monedhës metalike shqiptare me kurs ligjor, prerja 100 Lekë"
9. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr.37, datë 6.8.2025 "Për mbajtjen e pandryshuar të normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes dhe të normave të interesit të depozitës njëditore dhe të kredisë njëditore në Bankën e Shqipërisë"
10. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr.38, datë 6.8.2025 "Për dhënien e miratimit paraprak për licencimin e degës së bankës së huaj në Republikën e Shqipërisë "Dega e Bankës Turkiye Cumhuriyeti Ziraat Bankasi A.S., Albania""
11. Vendim i Departamentit të Mbikëqyrjes të Bankës së Shqipërisë, nr.prot.5988, datë 8.8.2025 "Për dhënien e miratimit paraprak për bashkimin me përthithje të shoqërisë së kursim-kreditit "Tirana Invest Kredit 2000" me shoqërinë e kursim-kreditit "Fushas Mumajes""

TREGUESI I LËNDËS PËR BULETININ ZYRTAR, VËLLIMI 27, NUMËR 4,  
SHTATOR 2025

1. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 42, datë 3.9.2025 "Për disa ndryshime në rregulloren "Për licencimin, organizimin, veprimtarinë dhe mbikëqyrjen e zyrave të këmbimit valutor""
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 43, datë 3.9.2025 "Për miratimin e rregullores "Për funksionimin e sistemit të pagesave ndërbankare me vlerë të madhe – AIPS""

TREGUESI I LËNDËS PËR BULETININ ZYRTAR, VËLLIMI 27, NUMËR 5,  
SHTATOR 2025

1. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 44, datë 3.9.2025 "Për miratimin e rregullores "Për funksionimin e sistemit AIPS Euro për shlyerjen e transfertave vendase për klientë në Euro""
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr.45, datë 3.9.2025 "Për miratimin e rregullores "Për funksionimin e sistemit të klerimit të pagesave me vlerë të vogël – AECH""

TREGUESI I LËNDËS PËR BULETININ ZYRTAR, VËLLIMI 27, NUMËR 6,  
SHTATOR 2025

1. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr.46, datë 3.9.2025 "Për miratimin e rregullores "Për organizimin e brendshëm të funksionimit të sistemit të pagesave ndërbankare me vlerë të madhe – AIPS dhe sistemit AIPS Euro""
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr.47, datë 3.9.2025 "Për miratimin e rregullores "Për organizimin e brendshëm të funksionimit të sistemit të klerimit të pagesave me vlerë të vogël – AECH""
3. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr.48, datë 3.9.2025 "Për miratimin e rregullores "Për funksionimin e sistemit SWIFT në Bankën e Shqipërisë""
4. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr.49, datë 3.9.2025 "Për miratimin e disa ndryshimeve në rregulloren "Për përcaktimin e kërkesave për transfertat e kreditit dhe të debitimit direkt në Euro""
5. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr.50, datë 3.9.2025 "Për miratimin e rregullores "Për organizimin e ekspozitave të përkohshme të vlerave numizmatike dhe objekteve muzeore të Bankës së Shqipërisë, brenda dhe jashtë Bankës së Shqipërisë""





